



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 95

Tiranë – E martë, 27 qershor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 38/2023, datë 8.6.2023	Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 10119
Dekret i Presidentit nr. 86, datë 23.6.2023	Për shpallje ligji..... 10119
Ligj nr. 39/2023, datë 8.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”..... 10119
Dekret i Presidentit nr. 88, datë 26.6.2023	Për shpallje ligji..... 10121
Ligj nr. 40/2023, datë 8.6.2023	Për disa ndryshime dhe një shtesë në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”..... 10122
Dekret i Presidentit nr. 87, datë 23.6.2023	Për shpallje ligji..... 10122
Vendim i Kuvendit nr. 46/2023, datë 15.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar..... 10122
Vendim i Kuvendit nr. 47/2023, datë 15.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar 10123
Vendim i Kuvendit nr. 48/2023, datë 15.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar 10123
Vendim i Kuvendit nr. 49/2023, datë 15.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar 10123
Vendim i Kuvendit nr. 50/2023, datë 15.6.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar..... 10124

Rezolutë e Kuvendit datë 15.6.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Departamentit të Administratës Publike për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2022.....	10124
Rezolutë e Kuvendit datë 15.6.2023	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022.....	10125
Dekret i Presidentit nr. 85, datë 21.6.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	10126
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 21.6.2023	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë” sh.a., të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330	10127
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 15, datë 15.6.2023	Mbi përcaktimin e kriterëve dalluese mes ushqimit për kafshë, aditivëve ushqimorë për ushqime për kafshë, produkteve biocide dhe produkteve mjekësore veterinarë.....	10132
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 187, datë 6.6.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10135
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 188, datë 6.6.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10136
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 189, datë 6.6.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10137
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 190, datë 6.6.2023	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	10138
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 191, datë 6.6.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “S.p.v. Blue 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.....	10139
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 256/15, datë 27.6.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Himarë dhe largimi i ujërave të trajtuara në det për ITUN Himarë”.....	10142
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 2159, datë 12.5.2023	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Behari Murataj	10144

**LIGJ**
Nr. 38/2023**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.**
9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 9, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Subjektet e përpunimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij, si dhe subjektet e prodhimit të produkteve ushqimore të ambalazuara, të cilat kanë në përbërje të tyre qumësht pluhur të klasifikuar në kodet 0402 10 19 dhe 0402 21 18 të NKM-së, hirrë qumështi të klasifikuar në kreun 0404 10 të NKM-së dhe krem qumështi të klasifikuar në kreun 0402 të NKM-së, përjashtohen nga pagimi i taksës për qumështin pluhur, taksës për hirrë qumështi dhe taksës për krem qumështi vetëm për sasinë e importuar, për qëllim prodhimi, në përputhje me etiketën e produktit të miratuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku evidentohet sasia në përqindje të këtyre produkteve, që janë trupëzuar në produktin përfundimtar.

Në rast të përdorimit të qumështit pluhur, hirrës së qumështit dhe krem qumështi, jo për qëllimet e veta dhe me destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin përfitohet përjashtimi sipas kësaj pike, subjektet e përpunimit dhe prodhimit të këtyre produkteve detyrohen të paguajnë të gjithë vlerën e taksës për të cilën kanë përfituar përjashtimin. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, autoritetet tatimore kryejnë kontrolle periodike. Kriteret, kushtet dhe procedurat e përjashtimit, si dhe periodiciteti i kontrollit, sipas kësaj pike, përcaktohen me

udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për kontrollin ushqimor.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 86, datë 23.6.2023,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 86, datë 23.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 38/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, ‘Për taksat kombëtare’”, të ndryshuar.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 39/2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 80/2020,
“PËR POLICINË E BURGJEVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



Neni 1

Në nenin 14 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punonjësit në Policinë e Burgjeve e mbajnë armën në përdorim personal edhe jashtë orëve të shërbimit, sipas kushteve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1

**E drejta për përfitim kredie
me kushte lehtësuese**

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton kredi për strehim me kushte lehtësuese.

2. Kriteret dhe procedura për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe masa e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Në pikën 1, të nenit 29 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtje penale me dashje;”.

2. Pas shkronjës “d” shtohet shkronja “d/1” me këtë përmbajtje:

“d/1) ndaj tij nuk është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale ose nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje;”.

3. Shkronja “ë” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 37, pika 4, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 38, pika 1, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronja “a” shfuqizohet.

2. Në shkronjën “b” pas fjalës “ekzekutive” shtohet fjala “mbikëqyrëse”.

Neni 6

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 fjala “Nëninspektor” zëvendësohet me fjalën “Inspektor”.

2. Në pikën 2, shkronja “a”, nënparagrafi “i” shfuqizohet.

3. Pas pikës 2, të nenit 42, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Përfundimisht, punonjësi i rolit bazë, pavarësisht gradës, mund të marrë gradën “nënkomisar” kur plotëson kushtet e mëposhtme:

a) zotëron një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës ose të zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) është punonjës i rolit bazë për jo më pak se 2 vjet;

c) ka përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës “nënkomisar”;

ç) ka vlerësim vjetor pozitiv të punës për periudhën që ka qëndruar në gradën që mban;

d) është shpallur fitues në procedurat konkurruese për ngritjen në gradë “nënkomisar”.”

Neni 7

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51

Pezullimi

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve pezullohet nga detyra kur:

a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; ose,

b) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje.

2. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi përfiton 50% të pagës për gradë.

3. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë,



rikthehet në punë dhe kompensohet për pjesën e mbetur të pagës, që duhej të përfitonte nëse nuk do të ishte pezulluar.”.

Neni 8

Neni 55 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 55

Rikthimi dhe përparësia për pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve

1. Rikthimi në Policinë e Burgjeve mund të bëhet në çdo kohë vetëm për nevoja të Policisë së Burgjeve dhe nëse personi plotëson kërkesat e mëposhtme:

a) është liruar nga Policia e Burgjeve me kërkesën e tij për shkak të shkurtimit të funksionit ose për shkak të punësimit në struktura të tjera të administratës publike;

b) plotëson kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës.

2. Kriteret për rikthimin në Policinë e Burgjeve vlerësohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila përgatit raportin përfundimtar mbi përshtatshmërinë ose jo të kandidatit.

3. Punonjësi kandidat rikthehet në Policinë e Burgjeve në gradën që ka pasur para lirimit. Në rast të mungesës së vendit vakant me gradën e mëparshme dhe me pëlqimin e tij, ai pranohet në pozicion pune me gradë më të ulët.

4. Kanë përparësi për pranimin në Policinë e Burgjeve shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura, punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) janë liruar nga detyra me kërkesën e tyre ose janë liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të funksionit;

b) plotësojnë kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës.

5. Kriteret për përparësinë në pranimin në Policinë e Burgjeve vlerësohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila përgatit raportin përfundimtar mbi përshtatshmërinë ose jo të kandidatit.

6. Punonjësi kandidat pranohet në Policinë e Burgjeve në gradën që ka pasur para lirimit. Në rast

të mungesës së vendit vakant me gradën e mëparshme dhe me pëlqimin e tij, ai pranohet në pozicion pune me gradë më të ulët.

7. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe punonjësit e rolit të lartë drejtues emërohen nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

8. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë, ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, miraton rregullat për ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi me gradat e Policisë së Burgjeve.”.

Neni 9

Dispozita tranzitore

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, punonjësit e Policisë të Burgjeve me gradën “Nëninspektor” marrin gradën “Inspektor”.

2. Koha e qëndrimit në gradën “Nëninspektor” të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, për efekt të ecurisë në gradë, konsiderohet si kohë e qëndrimit në gradën “Inspektor”.

Neni 10

Hyryra në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.6.2023.

Shpallur me dekretin nr.88, datë 26.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 88, datë 26.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,



DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 39/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, Për Policinë e Burgjeve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 40/2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË
SHITESË NË LIGJIN NR. 68/2017,
“PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES
VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë:

Neni 1

Në nenet 55, pikat 1 dhe 2, 56, pika 1, 57, pika 1, dhe 59, pika 1, fjalët “të shpenzimeve vjetore të miratuara” zëvendësohen me fjalët “të shpenzimeve vjetore faktike”.

Neni 2

Pas nenit 60 shtohet neni 60/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 60/1

**Përdorimi i fondeve të
trashëguara nga viti i kaluar**

1. Nga fondet e trashëguara dhe të paangazhuara, jo më pak se 30% e tyre përdoren për:

- a) shlyerjen e detyrimeve të prapambetura;
b) pagimin e nënhuave të papaguara në kohë.

2. Procedurat dhe mënyra e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti i kaluar dhe të paangazhuara, që do të përdoren për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe pagimin e nënhuave të papaguara në kohë, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.6.2023.

Shpallur me dekretin nr. 87, datë 23.6.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, **Bajram Begaj**.

DEKRET
Nr. 87, datë 23.6.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93, të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 40/2023, “Për disa ndryshime dhe një shtesë në ligjin nr. 68/2017, Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 46/2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputetja Mirela Pitushi caktohet anëtare e Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

VENDIM
Nr. 47/2023**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputetja Orjela Nebiaj caktohet anëtare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

VENDIM
Nr. 48/2023**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Asllan Dogjani caktohet anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare.”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

VENDIM
Nr. 49/2023**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të



përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Lodovik Hasani caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

**VENDIM
Nr. 50/2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN E
ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË
PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I të vendimit nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Asllan Dogjani caktohet anëtar zëvendësues i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.”

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
DEPARTAMENTIT
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR
GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL
PËR VITIN 2022**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Departamentit të Administratës Publike si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;

Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;

Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së administratës publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2022 në drejtim të:

Unifikimit të zbatimit të ligjit në shërbimin civil.

Ngritjes së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).

Ofrimit të shërbimeve online ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike.

Zbatimit të rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimit dhe përfshirjes në projektet “IPA II European Union Integration Facility 2020 “Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të administratës publike, përfshirë trajnimet/praktikat në administratat e vendeve anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (“qelizat e reja”)” dhe “Projekti Anketa e ReSPA për nëpunësit publikë në Ballkanin Perëndimor”.

Organizimit, marrjes pjesë brenda dhe jashtë vendit në aktivitete të ndryshme.

Bashkëpunimit me KMSHC duke nisur punën për hartimin e një drafti të parë të projektligjit për ndryshime në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.



Rekrutimit në shërbimin civil në lidhje me pozicionet e lira, procedurat e rekrutimit, aplikimet për procedurat e konkurrimit, plotësimin e pozicioneve vakante në shërbimin civil, lirimet në shërbimin civil.

Administrimit të formularëve të vetëdeklarimit të plotësuar nga subjektet vetëdeklaruese në zbatim të ligjit nr. 138/2015.

Procese të ristrukturimit dhe krijimit të institucioneve të reja.

Realizimit të rritjes së pagës minimale nga 30.000 lekë në muaj në 32.000 lekë në muaj me VKM-në nr. 158, datë 12.3.2022.

Realizimit të rritjes së pagës minimale nga 32.000 lekë në muaj në 34.000 lekë në muaj me VKM-në nr. 604, datë 14.9.2022.

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike për vitin 2023 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të realizojë procedurat e konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv në përputhje me parimet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, duke i ndërtuar me eficiencë grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë, si dhe kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të rekrutimit.

2. Duhet të vijojë punën e tij drejt rritjes së cilësisë së trupës së nëpunësve civilë të rekrutuar nëpërmjet ndërveprimit me qytetarët, me qëllim rritjen e numrit të konkurrentëve, duke publikuar në portalin “online” të aplikimit informacionet që shërbejnë për të kuptuar procedurat e rekrutimit dhe për t’i ndërgjegjësuar ata për rëndësinë e rritjes së nivelit të pjesëmarrjes në këto procedura.

3. Departamenti i Administratës Publike duhet të tregojë nivel më të lartë bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore, me qëllim raportimin e pozicioneve të lira për të siguruar rritjen e efektivitetit në realizimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me dispozitat ligjore.

4. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike duhet të krijojë infrastrukturën për ofrimin e kurseve online; duhet të krijohet cikli i trajnimit për menaxhimin e cilësisë; duhet të merren masa lidhur me përmirësimin e aftësisë administrative të nëpunësve civilë të nivelit vendor.

5. Të angazhohet në automatizimin e sistemit të listëpagesave nëpërmjet sistemit informatik të burimeve njerëzore në të gjithë sektorin publik.

6. Të hartojë Strategjinë e re Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për vitin 2023 e në vijim.

7. Në përcjelljen e raportit në Kuvend t’u referohet rregullave të përcaktuara në vendimin e Kuvendit nr. 134/2018

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;

Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t’i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur me synim mirëqenien e konsumatorit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2022 në drejtim të:

Përfshirjes në procesin e konsultimit publik të ndryshimeve të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe identifikimin e marrëveshjeve në ofertat e procedurave të prokurimit publik.

Intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike për çështjet e rregullimit të tregut, me qëllim sigurimin e njohurive të nevojshme për shumë profesionistë në fushën e konkurrencës.

Përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 – 2023 në kuadër të përputhshmërisë së plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.



Monitorimit në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës organeve të administratës shtetërore dhe enteve rregullatore sipas tregjeve që ato rregullojnë.

Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe përmirësimit të nivelit të ekspertizës së stafit për t'iu përshtatur dinamikës së tregjeve në zhvillim.

Forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe për të huazuar praktikat më të mira në fushën e konkurrencës.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2023 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të veprojë në kohën e duhur dhe me gjithë forcën e ligjit për ndëshkimin e operatorëve të tregut me sjellje të përsëritur në shkelje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit.

2. Të monitorojë sjelljen e ndërmarrjeve të prekura nga transaksioni i përqendrimit në tregun e telefonisë celulare në kushtet kur struktura e tregut ka ndryshuar tërësisht.

3. Të ndjekë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e monitoruara apo të hetuara gjatë vitit 2022. Të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve, të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare në fuqi apo atyre të rejave, si: projekti i investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”.

4. Të ndër marrë një procedurë monitorimi apo hetimi në tregun e shërbimit spitalor privat, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg, në kushtet e ndryshimeve të pronësisë së spitaleve private gjatë viteve të fundit.

5. Të nxisë bashkëpunimin me Agjencinë e Prokurimit Publik për raportimin e rasteve të dyshuara në shkelje të konkurrencës dhe të jetë më proaktiv në zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara në fushën e prokurimeve publike.

6. Të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si: tregu i prodhimit të qumështit dhe nënproduktet e tij, tregu i ushqimeve, sidomos artikujt bazë të shportës, tregu i karburanteve, tregu i materialeve të ndërtimit, etj.

7. Të vijojë përpjekjet për sigurimin e mbështetjes financiare për digjitalizimin e arkivit dhe protokollit të Autoritetit.

8. Të vijojë promovimin e kulturës së konkurrencës përmes intensifikimit të marrëdhënieve me botën akademike, strukturat e biznesit dhe institucionet e tjera publike e private për çështjet e rregullimit të tregut, mbarëvajtjes së konkurrencës dhe mirëqenies së konsumatorit.

9. Të vijojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat evropiane në fushën e konkurrencës.

10. Të forcojë kapacitetet administrative nëpërmjet trajnimit të stafit me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave dhe mbrojtjes së vendimeve të Komisionit të Konkurrencës në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ, që ka si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe veçanërisht për kontratat koncesionare.

Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 15.6.2023.

DEKRET
Nr. 85, datë 21.6.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, nenit 14, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Florida Hatem Ruçi (Guri)
2. Anxhela Remzi Drazhi
3. Aida Xhevdet Velia (Abdiu)
4. Benet Luigj Shkreli
5. Migena Gëzim Hazizi
6. Besmir Mustafa Meierschitz (Hasani)
7. Gentjan Shaban Uraj
8. Alda Flamur Mehmeti
9. Anisa Siri Duka
10. Elias Arbër Zika
11. Alex Arbër Zika
12. Valmirë Brahim Dani (Avdija)
13. Erjona Fatmir Dani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 378, datë 21.6.2023

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
DREJTËSISË, PËR PROKURORINË E
POSAÇME, DHE REVOKIMIN E SË
DREJTËS SË PRONËSISË BASHKISË
TIRANË, SHOQËRISË “UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE TIRANË” SHA, TË
PASURISË NR. 8/123, NË ZONËN
KADASTRALE 8330**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar,

dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330, me emërtimin “Inkubatori i biznesit”, Tiranë, me qëllim sigurimin e ambienteve të punës për Prokurorinë e Posaçme, sipas certifikatës së regjistrimit, kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Kalimi në përgjegjësi administrimi i pronës te Ministria e Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet duke përfshirë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ndërtimi i objektit mbi këtë pronë, sipas lejes së ndërtimit nr. S-6519/6, miratuar me vendimin nr. S-6519/7, datë 8.10.2020, të kryetarit të Bashkisë Tiranë.

3. Prokuroria e Posaçme është përgjegjëse për ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha procedurave sipas legjislacionit në fuqi deri në regjistrimin e objektit.

4. Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme, Bashkia Tiranë, shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” sh.a., dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

CERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË	L72320033P	1/1

Numri i Pasurisë	8/123		
Kodi Unik	8330024060		
Zona Kadastrale	8330		
Lloji i Pasurisë	TRUALL		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 2264	Truall: 2264	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë			
Adresa e Pasurisë	TIRANE, TIRANE, Rr.: JORDAN MISJA		

DREJTORI
Elira GogoElira
GogoDigitally signed by:
Elira Gogo
Date: 2023.03.24
02:13:48 +02'00'

Data e lëshimit 23/03/2023

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date: 2023/03/23 17:09:51 +02'00'
L72320033P2023032317094448L1014Shënim : Ky dokument është gjeturuar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

Miratuar me VCM 762, Datë 07.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8330024060
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8330, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 8/123, Sipërfaqja Totale 2264 m²,
(Nga të Cilat Truall 2264 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-L-10, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia TIRANE, Rruga JORDAN MISJA, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Filjestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË, Nr. Identifikimi/NIPT L72320033P, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Regjistruar: Nr. 00021225, Datë: 23/03/2023

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____
Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____, Emërtimi i Aktit: ____, Nr. __, Datë: ____

Regjistruar: Nr. __, Datë: ____

Përshkrimi: L.N. 2,422 M2

DREJTORI
Elira Gogo

Elira
Gogo

Digitally signed by:
Elira Gogo
Date: 2023.03.24
02:46:08 +02'00'

Data e lëshimit 23/03/2023



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Data: 2023/03/23 17:09:32 +02'00'
L72320033P2023032317092549ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËRËRE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8330

KODI UNIK: 8330024060

NUMRI PASURISË: 8/123

INDEKSI HARTËS: TR-L-10

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 500

DREJTORI
Elira GogoElira
GogoDigitally signed by:
Elira Gogo
Date: 2023.03.24
3/24/2023
02:15:38 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date: 2023/03/24 08:53:59 +02'00'
L72320033P202303240853494214014Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES

- ☐ PARCELA
- ☒ NDËRTESA

**UDHËZIM****Nr. 15, datë 15.6.2023****MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DALLUESE MES USHQIMIT PËR
KAFSHË, ADITIVËVE USHQIMORË
PËR USHQIME PËR KAFSHË,
PRODUKTEVE BIOCIDË DHE
PRODUKTEVE MJEKËSORE
VETERINARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e kriterëve dalluese mes ushqimit për kafshë, aditivëve ushqimorë për ushqime për kafshë, produkteve biocide dhe produkteve mjekësore veterinarë, duke krijuar një profil për secilin produkt sipas karakteristikave specifike, në përputhje me shtojcën e këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Frida Krifca

**SHTOJCË
PËRKUFIZIMET**

1.1 Termat e përcaktuar në këtë shtojcë kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

Për qëllimin e kësaj shtojce do të zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

“Ushqim për kafshë” është përkufizimi sipas pikës 4, të nenit 3, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

“Materiale për ushqim për kafshë” nënkupton produktet me origjinë bimore ose shtazore, qëllimi kryesor i të cilave është të plotësojnë nevojat ushqimore të kafshëve, në gjendjen e tyre natyrore, të freskëta ose të konservuara, dhe produkte të përfituara nga përpunimi industrial i tyre, substanca organike ose inorganike, që përmbajnë apo jo aditivë ushqimorë për ushqime për kafshë, të cilët janë të destinuar për përdorim në ushqimin oral të kafshëve qoftë drejtpërdrejt në gjendjen e tyre të papërpunuar ose pas përpunimit, ose në përgatitjen e ushqimit të përbërë, ose si bartës të premikësve.

“Bartës” nënkupton një substancë e cila përdoret për të tretur, holluar, shpërndarë ose ndryshe për të modifikuar fizikisht një aditiv ushqimor për ushqimin për kafshë, për të lehtësuar trajtimin, aplikimin ose përdorimin e tij pa ndryshuar funksionin e tij teknologjik dhe pa ushtruar vetë ndonjë efekt teknologjik.

“Ushqim për kafshë i destinuar për qëllime të veçanta ushqimore” nënkupton ushqimin për kafshë që mund të plotësojë një qëllim të caktuar ushqimor për shkak të përbërjes së tij të veçantë ose metodës së prodhimit, gjë që e dallon qartë atë nga ushqimi i zakonshëm. Ushqimi për kafshë të destinuara për qëllime të veçanta ushqimore nuk përfshijnë ushqimet e medikuara për kafshë.

“Ushqyerja nga goja e kafshëve” nënkupton futjen e ushqimit në traktin gastrointestinal të një kafshe përmes gojës me qëllim të plotësimin të nevojave ushqimore të kafshës dhe/ose ruajtjen e produktivitetit të kafshëve normalisht të shëndetshme.

“Aditiv ushqimor për ushqime për kafshë” nënkupton substanca, mikroorganizma ose preparate, të ndryshme nga materialet për ushqimin për kafshë dhe premikset, të cilat janë shtuar qëllimisht në ushqimin ose ujën për kafshë për të kryer, në veçanti, një ose më shumë funksione specifike, të cilat kanë si qëllim të:

- a) ndikojnë në mënyrë të favorshme në karakteristikat e ushqimit për kafshë;
- b) ndikojnë në mënyrë të favorshme në karakteristikat e produkteve shtazore;
- c) ndikojnë në mënyrë të favorshme në ngjyrën e peshqve dhe zogjve dekorativë;
- d) plotësojnë nevojat ushqimore të kafshëve;
- e) ndikojnë në mënyrë të favorshme në pasojat mjedisore të prodhimit të kafshëve;



dh) ndikojnë në mënyrë të favorshme në prodhimin, performancën ose mirëqenien e kafshëve, veçanërisht duke ndikuar në florën gastro-intestinale ose tretshmërinë e ushqimeve, ose;

e) kanë një efekt koksidiostatik ose histomonostatik.

“Ndihmës për përpunim” nënkupton çdo substancë që nuk konsumohet si ushqim për kafshë në vetvete, e përdorur qëllimisht në përpunimin e ushqimeve për kafshë ose materialeve për ushqim për kafshë, për të përmbushur një qëllim teknologjik gjatë trajtimit ose përpunimit, i cili mund të rezultojë në praninë e paqëllimshme, por teknologjikisht të pashmangshme të mbetjeve të substancës ose derivatet e tij në produktin përfundimtar, me kusht që këto mbetje të mos kenë një efekt negativ në shëndetin e kafshëve, shëndetin e njerëzve ose mjedisin dhe të mos kenë ndonjë efekt teknologjik në ushqimin për kafshë, përfundimtar.

Materialet e ushqimit për kafshë përdoren kryesisht për të plotësuar nevojat e kafshëve, për shembull për energji, lëndë ushqyese, minerale ose fibra dietike. Zakonisht ato nuk janë të mirëpërcaktuara kimikisht, me përjashtim të përbërësve bazë ushqyes. Efektet që mund të argumentohen nga vlerësimi shkencor dhe që janë ekskluzive për aditivët ushqimorë për ushqime për kafshë ose medikamentet veterinarë duhet të përjashtohen nga objektivat e përdorimit të materialeve të ushqimit për kafshë.

1.2 Dallimet midis ushqimeve për kafshë dhe aditivëve ushqimorë për ushqimin për kafshë

1.2.1 Ndryshimet

- “Aditivët ushqimorë për ushqime për kafshë janë substanca të ndryshme nga materialet ushqimore për kafshë”: një produkt nuk mund të jetë një material ushqimor dhe një aditiv ushqimor për ushqime për kafshë në të njëjtën kohë.

- “Nevojat ushqimore të kafshëve”: nuk është e mundur të tregohet një listë shteruese e elementeve përkatëse, por karakteristikat e mëposhtme të materialeve ushqimore për kafshë mund të konsiderohen si më të rëndësishmet:

a) për të furnizuar energji, lëndë ushqyese, minerale ose fibra dietike, dhe;

b) për të ruajtur funksionin e traktit intestinal.

- “Qëllimi kryesor është plotësimi i nevojave ushqimore të kafshëve” dhe “përdorimi kryesisht për të përmbushur nevojat e kafshëve”: përveç funksionit të zakonshëm primar të shpërndarjes së lëndëve ushqyese të kafshët, materialet e ushqimit për kafshë mund të kenë qëllime të tjera, për shembull nëse përdoren si bartës ose nëse nuk janë të tretshëm në traktin e zorrëve të kafshëve. Kjo është në përputhje me qëllimet e “ushqyerjes nga goja të kafshëve” (“plotësimi i nevojave ushqimore të kafshës dhe/ose ruajtja e produktivitetit të kafshëve normalisht të shëndetshme”) që korrespondon me përdorimin e synuar parësor sipas përkufizimit të “ushqimit për kafshë”.

1.2.2 Kriteret që duhen mbajtur parasysh në vlerësimin rast pas rasti

- “Metoda e prodhimit dhe përpunimit” - përkufizimi kimik dhe niveli i standardizimit ose purifikimit: produktet me origjinë bimorë ose shtazore në gjendjen e tyre natyrore, të freskëta ose të konservuara, dhe produktet që rrjedhin nga përpunimi i thjeshtë i tyre, si dhe substanca organike ose inorganike mund të konsiderohen materiale ushqimore për kafshë (p.sh. acide yndyrore ose karbonat kalciumi). Substancat e mirëpërcaktuara kimikisht që pastrohen dhe japin një nivel të caktuar standardizimi të garantuar nga prodhuesi mund të kualifikohen si aditivë ushqimorë për ushqime për kafshë (p.sh. vaji aromatik i nxjerrë në mënyrë specifike nga materiali bimor). Megjithatë, disa materiale ushqimore janë substanca të mirëpërcaktuara kimikisht dhe të standardizuara (p.sh. saharoza). Nga ana tjetër, produktet natyrore të bimëve të plota dhe pjesët e tyre ose produktet e tyre që rezultojnë nga një përpunim fizik i kufizuar si grimcimi, bluarja ose tharja do të konsiderohen materiale ushqimore për kafshë.

- Siguria dhe mënyra e përdorimit: Nëse për arsye të shëndetit të kafshëve ose njerëzve është e nevojshme të vendoset një përmbajtje maksimale e produktit në racionin ditor, produktet kualifikohen për klasifikim si aditiv. Megjithatë, edhe për materiale të caktuara për kafshë, zbatohen normat maksimale të përfshirjes. Statusi i aditivëve ushqimorë për ushqime për kafshë mund të ofrojë mundësinë për një menaxhim efektiv të produktit në aspektin e stabilitetit, homogjenitetit dhe në lidhje me mbidozimin. Aditivët ushqimorë për ushqime për kafshë zakonisht përdoren me shkallë



të ulët të përfshirjes në racionin ditor. Megjithatë, shumë materiale ushqimore për kafshë, të tilla si kripërat minerale, përdoren gjithashtu me shkallë të ulët të përfshirjes në racionin e ushqimit për kafshë.

- Funksionaliteti: Aditivët ushqimorë për ushqime për kafshë dhe funksionet e tyre janë përcaktuar sipas pikës 1.1. Këto funksione nuk janë të përcaktuara vetëm për aditivët ushqimorë. Një material ushqimor për kafshë mund të ketë gjithashtu një funksion shtesë (p.sh. si trashës), por ky nuk duhet të jetë i vetmi funksion i tij.

2. Produkt biocide

“Produkte biocide” janë substanca aktive dhe preparate që përmbajnë një ose më shumë substanca aktive, të vendosura në formën në të cilën ato i jepen përdoruesit, të destinuara për të shkatërruar, penguar, për të bërë të padëmshme, të parandaluar veprimin ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrojnë një efekt kontrollues mbi çdo organizëm të dëmshëm me mjete kimike ose biologjike.

“Substanca aktive” është një substancë ose mikroorganizëm duke përfshirë një virus ose një kërpudhë që ka veprim të përgjithshëm ose specifik mbi, ose kundër organizmave të dëmshëm.

“Organizëm i dëmshëm” është çdo organizëm që ka një prani të padëshiruar ose një efekt të dëmshëm për njerëzit, aktivitetet e tyre ose produktet që ata përdorin ose prodhojnë, ose për kafshët ose për mjedisin.

“Konservantë” janë substanca ose, kur është e aplikueshme, mikroorganizma që mbrojnë ushqimin ndaj dëmtimit të shkaktuar nga mikroorganizma ose metabolitëve të tyre.

Produktet me një grup treguesish përshkrimesh brenda secilit lloj, duke përfshirë llojet e mëposhtme të produkteve të lidhura me ushqimin për kafshë:

Lloji i produktit 3: Produkte biocide të higjienës veterinare: Produktet në këtë grup janë produkte biocide të përdorura për qëllime të higjienës veterinare, duke përfshirë produktet e përdorura në zonat ku strehohen, mbahen ose transportohen kafshët.

Lloji i produktit 4: Dezinfektuesit e zonës së ushqimit dhe ushqimit për kafshë: Produkte të përdorura për dezinfektimin e pajisjeve, kontejnerëve, enëve të konsumit, sipërfaqeve ose tubacioneve të lidhura me prodhimin, transportin, ruajtjen ose konsumimin e ushqimit, ushqimit për

kafshë ose për pirje (përfshirë ujin e pijshëm) për njerëzit dhe kafshët.

Lloji i produktit 5: Dezinfektues të ujit të pijshëm: Produkte që përdoren për dezinfektimin e ujit të pijshëm (për të dy - njerëzit dhe kafshët).

Lloji i produktit 20: Konservues për ushqim ose ushqim për kafshë stok: Produkte të përdorura për ruajtjen e ushqimit ose ushqim për kafshë stok duke kontrolluar organizmat e dëmshëm.

2.1 Dallimi ndërmjet ushqimeve për kafshë dhe produkteve biocidale

Produktet që janë objekt i legjislacionit për ushqimin e kafshëve, duke përfshirë ndihmësit e përpunimit, nuk janë produkte biocide, por duhet të konsiderohen si ushqim për kafshë.

Produktet në llojet e produkteve 3 dhe 4, të përcaktuara në pikën 2 të kësaj shtojce, nuk konsiderohen si ushqim për kafshë.

Produkte të caktuara mund të kualifikohen për llojet e produkteve 5 ose 20 (dhe gjithashtu mund të konsiderohen si ushqim për kafshë, zakonisht një aditiv ushqimor për ushqime për kafshë. Legjislacioni për ushqimin për kafshë ka përparësi mbi legjislacionin për produktet biocide, produkte të tilla duhet të konsiderohen ushqim për kafshë. Produktet për të ruajtur ushqimin ose ujin për kafshët nuk janë produkte biocide.

Nëse produkte të tilla janë të listuara në llojin e produktit 5 ose 20, ato nuk janë të destinuara për t'u administruar te kafshët.

3. Produktet mjekësore veterinare (PMV)

Përkufizimet e mëposhtme janë të përcaktuara edhe në urdhrin nr. 370, datë 29.7.2014, “Për miratimin e rregullores Mbi produktet mjekësore veterinare”:

“Produkt mjekësor veterinar” është:

a) çdo substancë ose kombinim substancash të paraqitura si me veti për trajtimin, ose parandalimin e sëmundjeve te kafshët, ose;

b) çdo substancë ose kombinim substancash që mund të përdoret te kafshët me synimin ose për të rivendosur, korriguar ose modifikuar funksionet fiziologjike duke ushtruar një veprim farmakologjik, imunologjik ose metabolik, ose për të bërë një diagnozë mjekësore;

c) “Ushqime të medikuara për kafshë” nënkupton çdo përzierje e një produkti ose produkteve mjekësore veterinare dhe ushqimit për kafshë, ose ushqimeve për kafshë që është gati për tregtim dhe i destinuar për t'u ushqyer kafshëve pa



përpunim të mëtejshëm, për shkak të vetive të tij kuruese ose parandaluese, ose vetive të tjera si një produkt mjekësor i mbuluar, sipas përkufizimit “produkt mjekësor veterinar”.

Në rastet e dyshimit, duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat e tij, një produkt mund të përfshihet në përkufizimin ‘produkt mjekësor veterinar’, sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 370, datë 29.7.2014, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi produktet mjekësore veterinar’”.

Urdhri nr. 370, datë 29.7.2014, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi produktet mjekësore veterinar’” nuk zbatohet për ushqimet e medikuara për kafshë dhe aditivët ushqimorë për ushqime për kafshë, kur ato janë të përfshira në ushqimin e kafshëve dhe ushqimet shtesë për kafshët.

3.1 Dallimi mes ushqimit për kafshë dhe produkteve mjekësore veterinarë

Nëse, pas shqyrtimit të të gjitha karakteristikave të një produkti të paklasifikuar, konkluzioni është se ai mund të jetë një PMV, ai duhet të konsiderohet si një PMV (përparësia e legjislacionit të PMV-ve ndaj legjislacionit për ushqimin për kafshë, me përjashtim aditivët e autorizuar të ushqimit).

- Ushqimet e medikuara nuk janë PMV por një formë ushqimi që përmban parapërzierje medicinale (ose premikse të medikuara) dhe që i nënshtrohet një recete nga një veterinar.

- Bazuar në përkufizimin e “qëllime të veçantë ushqimore”, sipas pikës 1.1 të kësaj shtojce, është vendosur kufiri midis ushqimit për kafshë dhe produkteve mjekësore veterinarë. Qëllime të veçanta ushqyese si ‘mbështetja e funksionit të mëlçisë në rastin e insuficiencës kronike të mëlçisë’, ‘ulja e formimit të gurëve të uresë’ ose ‘ulja e rrezikut të komës puerperale’ mund të arrihen nga ushqimi për kafshë.

VENDIM

Nr. 187, datë 6.6.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1,

germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1378/3 prot., datë 1.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1378 prot., datë 8.5.2023, aplikoi për t’u licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 174, datë 18.5.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë sipas kërkesës së protokolluar në ERE.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.5.2023 dhe 20.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 28.5.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1379/3 prot., datë 24.5.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria në vijim nëpërmjet shkresës nr. 1379/4 prot., datë 25.5.2023, përcolli të plotë dokumentacionin e kërkuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të



ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 188, datë 6.6.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “PROINFINIT CONSULTING” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e

energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1379/5 prot., datë 1.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Proinfinit Consulting’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1379 prot., datë 8.5.2023, aplikoi për t'u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 175, datë 18.5.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë sipas kërkesës së protokolluar në ERE.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.5.2023 dhe 20.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 28.5.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1379/3 prot., datë 24.5.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria në vijim nëpërmjet shkresës nr. 1379/4 prot., datë 25.5.2023, përcolli të plotë dokumentacionin e kërkuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5);



shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Proinfinit Consulting” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin, në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Proinfinit Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 189, datë 6.6.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e

energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, si dhe neneve 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 999/8 prot., datë 1.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 999 prot., datë 3.3.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 77, datë 15.3.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për kërkesën e protokolluar në ERE.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.3.2023 dhe 17.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 4.4.2023 vendosi të zgjasë me 20 ditë vendimarrjen e Bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar nga ana e shoqërisë, ndërsa me vendimin nr. 143, datë 24.4.2023, u vendos shtyrja me 30 (tridhjetë) ditë pune e vendimarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s me qëllim saktësimin/sqarimin e dokumentacionit financiar. Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo



modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “FTL” sh.a. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin si vijon:

- Neni 16, germa “a”. Plotësuar.

- Neni 16, germa “b”. Plotësuar.

- Neni 16, germa “c”. Plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.9.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 190, datë 6.6.2023

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, si dhe neneve 10 dhe 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1356/4 prot., datë 1.6.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1356 prot., datë 2.5.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 167, datë 15.5.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës sipas kërkesës së protokolluar në ERE, për një afat 5-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.5.2023 dhe 18.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.5.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1356/3 prot., datë 17.5.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës



- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar si vijon:

Neni 16, pika 1, geramat “a”, “b” dhe “c”. Plotësuar.

Neni 16, pika 7. Plotësuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.11.2023.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 191, datë 6.6.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) TË ASETVE TË PALUAJTSHME TË CENTRALIT FOTOVOLTAIK “BLUE 1” NË FAVOR TË “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEST EUROPE S.A, SICAV-SIF”

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, germa “b”, dhe nenit 10 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/6 prot., datë 1.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘SPV BLUE 1’ sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE, për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 7.4.2023, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të centralit fotovoltaiik



“Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southest Europe S.A., SICAV-SIF”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 1135/2 prot., datë 14.4.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për këtë vendimmarrje, ndërsa me shkresën nr. 1135/3 prot., datë 18.4.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. duke e njoftuar mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së saj dhe duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht për këtë aplikim.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/4 prot., datë 11.5.2023, depozitoi në ERE dokumentacionin plotësues.

- Nga shqyrtimi i aplikimit të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, rezulton se dokumentacioni i këtij aplikimi është plotësuar tërësisht si vijon:

Neni 7, “Përmbajtja e kërkesës për transferim”:

Pika 1, germet: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, plotësuar;

Pika 3: plotësuar;

Pika 6: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaiik “Blue 1” në favor të “Green for Growth Fund Southest Europe S.A., SICAV-SIF” (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



SPV Blue 1

Rr. Themistokli Gërmenji, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 48 13 427

BLESSED
INVESTMENTMATRIX
KONSTRUKSION

ANEKSI 1

LISTA E ASETVE TË SHOQËRISË "SPV BLUE 1" SH.P.K.

Nr.	PËRSHKRIMI	SASIA	SPECIFIKIMET TEKNIKE	VLERA (EURO)
1.	Panel Diellor	103,554	TSM-DEG21C.20 Vertex Dual G lass Bifacial Monocrystalline 650 Wp and 655 Wp	€ 17,659,431
2.	Inverter	177	SG350HX-V115_S Five-hole TB_SG320HX_S_A	€ 2,492,580
3.	Transformatorë	6 1	MVS8960-LV MVS3200-LV	€ 1,538,750
4.	Pilota	19,229	Mikro-pilota ne beton C25/30	€ 1,221,301.91
5.	Struktura	1,832	Tracker VANGUARD 1P	€ 4,702,164.09
6.	Kablo dhe Aksesore (Pajisje LV) + Scada + Sistem CCTV	1,020,361 m	Kablo diellore/Kablo gjenerimi /Kablo për shërbime ndihmëse /Kablo të tensionit të lartë/ Togëzim/Struktura/Kuti kryqëzimi/Ndërtesa/Porta	€ 1,429,867
VLERA TOTALE (EURO)				€ 29,044,094

SPV Blue 1 sh.p.k.

Zenel Hysenbegasi

Administrator


Rr. Themistokli Gërmenji, Ndërtesa 1, Tiranë, Shqipëri

Të drejtat e autorit rezervuar. Ky dokument nuk mund të riprodhohet, publikohet ose vlihet në dispozicion të palëve të treta pa pëlqimin paraprak të SPV Blue 1 sh.p.k. Fajta 4 - 4

**KËRKESË****Nr. 256/15, datë 27.6.2023****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura Himarë dhe Largimi i Ujërave të Trajtuara në Det për ITUN Himarë”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 783,000 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Himarë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Himarë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 783,000 (shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR
I KOMISIONIT TË POSAÇËM TË
SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA HIMARË DHE LARGIMI I UJËRAVE TË TRAJTUARA NË DET PËR ITUN HIMARË”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM															SHËNIME (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasuritë etj.)	SHËNIME			
	Emri	Adresa	Mbiemri	Fshat ose qytet	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Specifika të vlerësimit	Pyll (m ²)	Ullishte (m ²)	Rrugë (m ²)	Terra (m ²)	Ndërtim (m ²)	PYLL			ULLISHTË			RRUGË			TERRA ¹⁾			NDËRTESË					VLERA TOTALE (lek)		
														Specifika (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Specifika (m ²)	Çmimi (lek)	Vlera (lek)	Specifika (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Specifika (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Specifika (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)					
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	W	X	Y	Z	AA	AB	AC	AD	AE	AF	AG	
1	Pronë shtet			Himarë	1952	1/927	Pyll	61043	6104	0	0	0	0	44780			0														0		
2	Pronë shtet			Himarë	1952	1/1646	Ullishte	26580	0	26580	0	0	0					5034		0											0		
3	Pronë shtet			Himarë	1952	1/1624	Rrugë	764	0	0	764	0	0									82		0							0		
4	Feta		Hysenaj	Himarë	1952	1/1799	Godinë	180	0	0	0	180	0												1800	4350	783000			0	783,000.00	Depo për hapje 1763.	Sipas raportit të vlerësimit të ndikimit Mjedisor dhe Social të përgatitur nga ekspertët i kontraktuar ka konkluduar se, ndërtesa është 100% e amortizuar dhe vlerësimi bëhet vetëm për tulla.
5	Shtet			Himarë	1952	1/1952	Terra	255	0	0	0	255	0												1770	0	0			0	Kjo pasuri okupohet nga Shkëlqim Shytiq. Mbi këtë pasuri ndodhet një ndërtesë pa leje.		
6	Pronë shtet			Himarë	1952	1/1161	Rrugë	1312	0	0	1312	0	0									888		0						0			
7	Republika	e	Shqipërisë	Himarë	1952	1/1135	Terra	6133	0	0	0	6133	0												430		0			0	Në administrim të përgjigjshëm Ministria e Mbrojtjes.		
8	Republika	e	Shqipërisë	Himarë	1952	1/1147	Terra	1353	0	0	0	1353	0												4110		0			0	Në administrim të përgjigjshëm Ministria e Mbrojtjes. Mbi këtë pasuri ndodhet 1 ndërtesë pa leje.		
SHUMA TOTALE																													783,000.00				

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2159, datë 12.5.2023, vendosi shpalljen e zhdukjes së shtetasit Behari Murataj me atësi

Myftar dhe amësi Xhemile, i datëlindjes 8.10.1951, lindur dhe banues në Bubës, Përmet, si dhe caktimin e shtetases Persije Murataj si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në emër të tij.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë